



Çfarë po ndodh në SHKOLLËN TONË?!

**Raport mbi të Drejtat e Fëmijëve,
Diskriminimin dhe Bullizmin në shkollë.**

- /// Shkolla 9-vjeçare "Jeronim De Rada", Elbasan
- /// Shkolla 9-vjeçare "Imelda Lambertini", Elbasan
- /// Shkolla 9-vjeçare "Shushicë", Shushicë, Elbasan
- /// Shkolla e mesme e përgjithshme "Fuat Babani" Devoll, Korçë



Çfarë po ndodh në SHKOLLËN TONË?!

**Raport mbi të Drejtat e Fëmijëve,
Diskriminimin dhe Bullizmin në shkollë.**

- // Shkolla 9-vjeçare "Jeronim De Rada", Elbasan
- // Shkolla 9-vjeçare "Imelda Lambertini", Elbasan
- // Shkolla 9-vjeçare "Shushicë", Shushicë, Elbasan
- // Shkolla e mesme e përgjithshme "Fuat Babani" Devoll, Korçë

Ky botim u realizua nga People in Focus si organizatë partnere në zbatimin e projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike”, i cili zbatohet nga Këshilli i Evropës dhe financohet nga Agjencia Suedeze për bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Grupi i punës i përfshirë në këtë raport:

MSc. Armelia Barçi

MSc. Iris Briçi

MSc. Isida Mansaku

MSc. Ejona Koni

Designer:

Dynamic Media Group

Author: © People in Focus

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose përcillet në asnjë formë apo me asnjë mjet, qoftë elektronik (CD-Rom, Internet etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çdo sistem ruajtje ose nxjerrje informacioni, pa pasur miratimin paraprak me shkrim nga People in Focus.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni People in Focus:

Adresa: *Rr: Islam Alla, Pall.1, Nr.10 Njësia Administrative Nr.10, Kodi Postar 1057 Tiranë, Shqipëri*

Website: *www.peopleinfocus.org*

Facebook: *People in Focus Albania*

Instagram: *peopleinfocusalbania*

Tel: *+355 42224927*

Tabela e Përmbajtjes

1.Rreth Projektit	3
2.Të Drejtat e Fëmijëve. Koncepti i Diskriminimit, Bullizmit dhe Paragjykit	8
3.Qasja metodologjike	12
4.Gjetjet e raportit	14
4.1 Të dhënat demografike	14
4.2 Gjendja aktuale në shkolla	14
4.2.1 Nxënësit	14
4.2.2 Stafi arsimor dhe mbështetës.	19
4.2.3 Prindërit	25
5.Sugjerime për përmirësim të mëtejshëm	29
6.Rekomandime	34
7.Foto Galeri	35
8.Aneks 1	37

1. Rreth Projektit

Promovimi i të drejtave të njeriut dhe vlerave qytetare janë thelbësore për të nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve në kulturën demokratike. Kuptimi i parimeve mbi të drejtat e njeriut siguron dhe forcon kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe të mirën e përgjithshme. Nxënësit kanë nevojë për një bazë njohurish dhe informacioni mbi të cilët ata mund të ndër marrin veprime, të sigurt dhe besimplotë.

Organizata People in Focus në kuadër të projektit “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri” i cili zbatohet nga Këshilli i Evropës (KiE) dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) zhvilloi disa aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese në disa nga shkollat e DRAP Korçë për promovimin e të drejtave të njeriut dhe kulturës demokratike. Kjo iniciativë kishte si qëllim promovimin dhe edukimin e qytetarisë demokratike të nxënësve të shkollave 9-vjeçare “Jeronim De Rada”, “Imelda Lambertini”, “Shushicë” në Elbasan dhe Shkollës së mesme të përgjithshme “Fuat Babani” në Devoll, Korçë.

Objektivat e projektit

- Rritja e **ndërgjegjësimit mbi të drejtat e njeriut** duke theksuar rëndësinë e individit për të kontribuar për një komunitet më të mirë.
- **Rritja e kapaciteteve dhe aftësive të nxënësve** për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe ndryshimin e perceptimit ndaj shkeljeve të tyre duke nxitur rolin e tyre si qytetarë aktiv.
- **Inkurajimi i kreativitetit tek nxënësit** për të marrë pjesë në aktivitete **kundër diskriminimit dhe bullizmit** dhe duke u bere shembull për bashkëmoshatarët dhe komunitetin e tyre.

Shkollat e përfshira

Ky projekt u zhvillua në shkollat 9-vjeçare “Imelda Lambertini”, “Jeronim de Rada”, “Shushicë” në Elbasan dhe Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Fuat Babani” në Devoll, Korçë.

Shkolla 9-vjeçare publike “Jeronim De Rada” ndodhet në qytetin e Elbasanit. Kjo shkollë është ndërtuar në vitin 1964 dhe ka funksionuar fillimisht si shkollë e mesme, por më pas u shndërrua në shkollë 9 –vjeçare. Shkolla ka afërsisht 400 nxënës dhe një staf arsimor prej 30 mësuesish. Shkolla ka 18 klasa mësimore nga klasa e I - IX prej 2 paralelesh. Shkolla “Jeronim De Rada” ka marrë pjesë në projekte të ndryshme si eTwinning, “Arsim i Kombinuar”, nisma “Shkolla qendër komunitare” etj. Qëllimi i pjesëmarrjeve është nxitja dhe thellimi mëtejshëm i njohurive të nxënësve.

Shkolla 9-vjeçare jopublike “Imelda Lambertini” ndodhet në qytetin e Elbasanit. Kjo shkollë është themeluar me mbështetjen e motrave domenikane rreth 30 vite më parë në qytetin e Elbasanit. Kjo shkollë synon të ofrojë cilësi të lartë në mësimnxënie dhe mësimdhënie, në përputhje me standardet bashkëkohore të vendit tonë dhe më gjerë. Misioni është edukimi global i personit bazuar në filozofinë Montessoriane -”Më ndihmo të bëj vetë, më ndihmo të mendoj vetë”. Shkolla ka 270 nxënës nga klasa e parë deri në të nëntën, prej një paralele.

Shkolla 9-vjeçare publike “Shushicë” ndodhet në njësinë administrative Shushicë, Bashkia Elbasan. Shkolla e parë në këtë fshat është hapur në vitin 1948 dhe ka qenë shkollë fillore. Në vitet 80-90 ka funksionuar shkolla e mesme bujqësore dhe më pas gjimnazi i cili u mbyll në vitin 1994. Në këtë shkollë mësojnë afërsisht 340 nxënës dhe 80 fëmijë ndjekin kopshtin. Ka një staf arsimor prej 34 mësuesish. Shkolla ka 18 klasa mësimore nga klasa I – IX dhe 4 grupe në kopësht. Shkolla **“Shushicë”** ka marrë pjesë në projekte të ndryshme si nisma “Shkolla qendër komunitare”, projekti “STEM” nga Vodafone, etj.

Shkolla e Mesme e Përgjithsme “Fuat Babani” në Bilisht është gjimnazi më i madh në bashkinë e Devollit, i themeluar në vitin 1957. Përgjatë viteve, shkolla ka pasur disa funksione, si shkollë e mesme bujqësore, shkollë e mesme me korrespondencë etj. Në vitin 2017, shkolla u rikonstruktua në bazë të standardeve europiane për zhvillimin e arsimit. Në vitin shkollor 2021-2022 gjimnazi “Fuat Babani” mori statusin “shkollë - qendër komunitare” në kuadër të cilës janë realizuar veprimtari dhe aktivitete me qëllimin kryesor vendosjen e partneriteteve shkollë-komunitet. Shkolla ka 15 klasa mësimore.

Objektivat e projektit

Aktivitetet e zhvilluara në shkollat e sipërcituara për përcimin e vlerave demokratike duke nxitur angazhimin e nxënësve dhe fuqizimin e tyre janë:

- Trajnim **“Të Drejtat e Njeriut = Vlerat Qytetare”** – Trajnimet e zhvilluara synuan ndërgjegjësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të nxënësve mbi të drejtat e njeriut duke u ndalur veçanërisht tek të drejtat e fëmijëve. Temat e trajtuara gjatë këtyre trajnimeve konsistojnë në: të drejtat e fëmijëve, diskriminimi, bullizmi, diversiteti në komunitet, paragjykimet etj. Nxënësit diskutuan mbi këto fenomene dhe trajtuan raste konkrete të ndodhura midis bashkëmoshatarëve.
- **“Theatre of the Oppressed”** – Pas trajnimeve të zhvilluara, nxënësit u angazhuan në shfaqje teatri. Ata u udhëzuan të krijonin një skenar mbi situata të caktuara ku të shfaqnin cënimin e të drejtave të tyre, diskriminimin apo bullizmin. Dy shfaqje teatri u vunë në skenë në çdo shkollë. Nxënësit, të cilët ishin në publik morën pjesë nëpërmjet opinionëve të tyre apo pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë duke zëvendësuar aktorët (nxënësit) në skenë.
- **“Lunch Talks”** – Prindër, mësues dhe nxënës u mbledhën në disa takime për të ndarë opinione, situata konkrete dhe eksperiencën e tyre mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve, diskriminimin dhe bullizmin

në ambientet e shkollës dhe jashtë saj. Ata u treguan të gatshëm të tregonin mbi problematikat e hasura dhe mekanizmat referuese për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, ata sugjeruan qasje dhe mënyra të tjera alternative si të ballafaqohen me këto fenomene.

- Raport **“Çfarë po ndodh në shkollën tonë?”** – Informacionet, sygjerimet, opinionet të diskutuara në “Lunch Talks” u pasqyruan në këtë raport. Ky raport ka për qëllim paraqitjen e situatës aktuale në shkolla dhe nxitjen për të ndërmarrë iniciativa në zgjidhjen dhe përmirësimin e mekanizmave referues.

- **“Hackathon - Child Hack Day”** – Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ndërgjegjësimi i mëtejshëm i nxënësve mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky aktivitet në formë konkursi, kishte si qëllim nxitjen e kreativitetit dhe angazhimin e nxënësve të krijojnë ide inovatore si aplikacione/website/aktivitete të cilët mund të promovojnë të drejtat e fëmijëve, të kontribuojnë në eliminimin e diskriminimit, të përmirësojnë mekanizmat e referimit të bullizmit në shkollë ose instrumente që do t’ju vijnë në ndihmë bashkëmoshatarëve të tyre dhe jo vetëm. Çdo shkollë pati një ide fituese, të cilën mund ta konkretizojnë më tej.

Të rinjtë janë motori i shoqërisë dhe nxitësit e ndryshimeve. Pjesëmarrja e fëmijëve dhe e të rinjve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut është e rëndësishme për një vend demokratik. Formësimi i tyre që në moshë të hershme ka rëndësi të veçantë në ndërtimin e së ardhmes dhe përforcimin e vlerave qytetare.

Ndërgjegjësimi dhe informimi i fëmijeve mbi vlerat, parimet dhe mjetet për të vepruar e mbrojtur këto parime, do të zhvillojnë qytetarë më të mirë në të ardhmen.



AKTIVITETE MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE



*Aktivitete të zhvilluara gjatë projektit në periudhën kohore Shkurt 2022-Prill 2023, në shkollat e targetuara në projekt.







<http://peopleinfocus.org/en/forcimi-i-edukimit-per-qytetari-demokratike-ne-shqiperi/>

2. Të Drejtat e Fëmijëve. Koncepti i Diskriminimit, Bullizmit dhe Paragjykimit

Të Drejtat e Fëmijëve garantohen nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 1989. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi Konventën për të Drejtat e Fëmijëve më 1991, e cila përshkruan të drejtat që kanë të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeç.



Të Drejtat e Fëmijëve:

<p>Neni 1</p>  <p>Përkufizimi i termit: fëmijë Fëmija është personi nën moshën 18 vjeç.</p>	<p>Neni 2</p>  <p>Mosdiskriminimi Asnjë fëmijë nuk duhet të diskriminohet për shkak të ngjyrës së lekurës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit, vendit të origjinës, gjëndjes ekonomike, paaftësisë ose përkatësisë në një pakicë etnike.</p>
<p>Neni 3</p>  <p>Mirëqënia e fëmijës është e rëndësishme Në të gjitha ligjet dhe vendimet juridike, mirëqënia e fëmijës është parësore.</p>	<p>Neni 4</p>  <p>Zbatimi i të drejtave Çdo shtet duhet ti sigurojë, në maksimumin e mundësive të tij, zbatimin e të drejtave të fëmijës.</p>
<p>Neni 13</p>  <p>Liria e shprehjes Çdo fëmijë ka të drejtë të shprehë lirisht opinionin e tij dhe të marrë e të përhapë informacion përmes medias. Çdo fëmijë ka përgjegjësinë për të shprehur mendimin e tij, duke respektuar mendimin e tjetrit.</p>	<p>Neni 28</p>  <p>Arsimi Çdo fëmijë ka të drejtë të arsimohet dhe shkollohet. Shteti ka detyrimin të ofrojë arsimin bazë falas dhe të bëjë të mundur arsimin e mesëm për të rinjtë. Shteti ka detyrimin të sigurojë që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe të drejtat e tyre të mos preken.</p>

¹Cituar disa prej tyre

Burimi: <https://www.living-democracy.com/sq/textbooks/volume-5/part-3/documents-and-teaching-material-4/>

Çfarë është diskriminimi?

“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo parapëlqim, pavarësisht nga shkaku, që ka si qëllim apo pasojë, pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga legjislacioni në fuqi.

Mosdiskriminim do të thotë trajtim i barabartë nga ligji, mundësi të barabarta nga shteti dhe shoqëria dhe masa për të ndaluar shkeljet dhe dallimet e padrejta.²

Çfarë është bullizmi?

Bullizmi përkufizohet si një sjellje antisociale dhe që shfaqet kur një individ ose një grup i caktuar individësh që kërkojnë përmes fuqisë, forcës ose pushtetit të tyre, si dhe për një kohë të caktuar e për një qëllim të paramenduar, të dhunojnë në mënyrë të përsëritur fizikisht, verbalisht, psikologjikisht ose emocionalisht.³

Një numër i madh studimesh (Suckling & Temple, 2002; Olweus, 1993) kanë treguar se kjo sjellje merr forma të ndryshme si mëposhtë:⁴

→ **Bullizëm fizik**

→ **Bullizëm verbal**

→ **Bullizëm social**

→ **Bullizëm seksual**

→ **Bullizëm virtual ose kibernetik**

²<https://www.unicef.org/albania/media/4506/file/Ligji%20per%20Mbrojtjen%20nga%20Diskriminimi.pdf>

³<https://www.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/09/Doktoratura-Emanuela-Ismaili-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-Pune-Sociale.pdf>

⁴<https://rm.coe.int/albania-study-report-on-bullying-alb/1680732871>

Çfarë është paragjykimi?

Paragjykimi është një supozim ose një opinion për dikë që bazohet thjesht në përkatësinë e atij personi. Për shembull, njerëzit mund të paragjykojnë dikë që i përket një komuniteti të caktuar, etnie, gjinie ose feje tjetër.

Diskriminimi, bullizmi dhe paragjykimi mund të kenë efekte negative dhe afatgjata tek individët dhe grupi i prekur prej tyre. Ky efekt mund të çojë në ulje të vetëvlerësimit, ankth, depresion dhe gjithashtu mund të ndikojë në shëndetin mendor dhe fizik në tërësi.

Është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për këto koncepte dhe të punojmë në mënyrë aktive drejt reduktimit dhe parandalimit të tyre në të gjitha aspektet e jetës.

3. Qasja metodologjike

Ky raport u hartua në vijim të “Lunch Talks”, pra takimeve të strukturuara si aktivitete që kishin për qëllim mbledhjen e të dhënave nëpërmjet bashkëbisedimit në mënyrë të drejtëpërdrejtë me nxënësit, prindërit e tyre dhe stafin arsimor dhe mbështetës të shkollave pjesëmarrëse. Ndarja e eksperiencave, opinionëve dhe sugjerimeve lidhur me zbatimin e të drejtave të fëmijëve, problematikat që ata mund të hasin për shkak të paragjyqimeve, bullizimit dhe diskriminimit ishin në fokus të këtyre takimeve.

Shkollat objekt të këtij raporti:

1. Shkolla 9-vjeçare publike “Jeronim De Rada” Elbasan, Klasa VI-VII-VIII-IX
2. Shkolla 9-vjeçare jopublike “Imelda Lambertini” Elbasan, Klasa VI-VII-VIII
3. Shkolla 9-vjeçare publike “Shushicë” Elbasan, Klasa V-VI-VII-VIII
4. Shkolla e Mesme e Përgjithsme “Fuat Babani” Bilisht, Devoll Klasa XI-XII

Hapat kryesore të ndjekura për përpilimin e këtij raporti:

I. Mbledhja e të dhënave

- A. Takime me nxënësit, stafin arsimor dhe mbështetës dhe prindërit e shkollave përkatëse
- B. Sondazh me anë të një pyetësori në përfundim të takimeve

II. Analizimi i të dhënave dhe hartimi i raportit. Gjithashtu, në bazë të kësaj analize u arrit në përfundime dhe rekomandime konkrete.

Instrumentet e përdorur janë të përmbledhur si mëposhtë:

Takimet: Duke synuar mbledhjen e të dhënave si sasiore ashtu edhe cilësore, takimet u zhvilluan duke përdorur teknikë të përzier.

Gjatë takimeve u morën parasysh pyetjet e hartuara paraprakisht, por gjithashtu, biseda u alternua edhe me diskutime spontane ku pjesëmarrësit ndanë mendimet dhe eksperiencat individuale. Gjatë këtyre takimeve u implementua metoda e vëzhgimit pa ndërhyrje dhe e komunikimit. Këto grupe u vëzhguan dhe u moderuan nga lehtësues të cilët drejtuan dhe simuluan diskutimin e pjesëmarrësve drejt identifikimit të problematikave të ndryshme.

Pyetësorët: Pyetësi është një instrument shumë efikas për mbledhjen e të dhënave sasiore, për këtë u pa e arsyeshme që në fund të çdo takimi të ndahej një pyetësor dhe të merrej opinioni, duke garantuar anonimin e informacionit të dhënë. Në fund të takimeve, pyetësi ishte i disponueshëm për pjesëmarrësit në “hard copy” dhe u plotësua duke aplikuar metodën “laps e letër”.

Në fillim të pyetësorit, u shpjegua shkurtimisht pjesëmarrësve qëllimi dhe objektivat kryesore. Pyetësi përmban 17 pyetje, kryesisht pyetjet të mbyllura me zgjedhje të shumëfishta, por u përfshinë edhe pyetje me fund të hapur (në mënyrë që pjesëmarrësit të jepnin përgjigje me fjalët e tyre). Me qëllim që të përfitohet sa më shumë informacion i saktë dhe i plotë, pyetësorët u përgatitën në forma dhe me pyetje të ndryshme, të përshtatura për secilin grup, pra një pyetësor për nxënësit dhe një për prindërit/stafin arsimor dhe mbështetës.

Kampioni dhe kriteret e tij:

- Takime ballë për ballë dhe sondazhi me anë të një pyetësi (ANEKS 1)
- Popullata: Nxënësit e shkollave të targetura, stafi arsimor dhe mbështetës dhe prindërit e tyre
- Kampioni: 93 nxënës, 41 staf arsimor dhe mbështetës, 33 prindër.

Metodologjia e përdorur bëri të mundur krijimin dhe ofrimin e një panorame të gjerë të gjendjes aktuale në këto shkolla lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve si dhe fenomenet e hasura si bullizimi, diskriminimi dhe paragjykimi.

4. Gjetjet e raportit

4.1 Të dhënat demografike

Të pranishëm në “Lunch Talks”, pra në takime ishin në total 93 nxënës, 41 staf arsimor dhe mbështetës dhe 33 prindër, të ndarë sipas shkollave si mëposhtë.

	Nxënës		Staf Arsimit & Mbeshtetes		Prindër	
	F.	M.	F.	M.	F.	M.
Shkolla 9-vjeçare “Imelda Lambertini”	21	16	8	1	2	-
Shkolla 9-vjeçare “Jeronim De Rada”	12	12	7	2	10	1
Shkolla 9-vjeçare “Shushicë”	9	1	13	1	10	1
Shkolla e mesme “Fuat Babani”	14	8	8	1	7	2

4.2 Gjendja aktuale në shkollë

4.2.1 Nxënësit

Njohuritë e nxënësve mbi të drejtat e fëmijëve

Të drejtat e fëmijëve janë një temë e rëndësishme për nxënësit. Gjatë takimeve nxënësit diskutuan dhe ndanë njohuritë e tyre mbi to. Ata nënvizuan se këto të drejta kanë filluar t'i mësojnë që në vitet e para të shkollimit.

Të drejtat të cilët ata përmendën më shumë janë:

- E drejta e të pasurit identitet;
- E drejta për të patur familje dhe shtëpi me kushte komode banimi;
- E drejta e lirisë së fjalës, e shprehjes së mendimeve dhe opinioneve;
- E drejta e marrjes pjesë në aktivitete të ndryshme sportive, kulturore

dhe artistike;

- E drejta për t'u argëtuar;
- E drejta për arsimim, etj.

Gjithashtu, ata theksuan rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit dhe jetës në përgjithësi nga organet shtetërore, të pasurit një jetë të sigurtë dhe me kushte të mira si dhe mbrojtjen nga bullizmi e diskriminimi.

▶ **Perceptimi i nxënësve mbi respektimin e të drejtave të tyre**

Përgjatë diskutimeve, nxënësit nuk hezituan të shprehnin perceptimin e tyre rreth respektimit të të drejtave të tyre në shkollë, familje dhe ambiente të tjera shoqërore. Ata deklaruan se të drejtat e tyre përgjithësisht respektohen në të shumtën e rasteve.


Gjatë takimeve, ata pohuan unanimisht se në **familje** të drejtat e tyre respektohen gjithmonë, por bazuar rezultateve të sondazhit anonim, 14% janë shprehur se të drejtat e tyre nuk respektohen në familje ose në ambiente të tjera familjare.

Për sa i përket **shkollës**, pjesa më e madhe e **nxënësve** janë të mendimit (87%) se të drejtat e tyre në përgjithësi respektohen nga stafi arsimor dhe mbështetës dhe nxënësit e tjerë. Gjithsesi, disa prej tyre shprehën pakënaqësi për mosrespektimin e disa nga të drejtave të fëmijëve në ambientet e shkollës (17%) dhe sidomos jashtë saj (49%). Sipas tyre, shkelja e të drejtave të tyre ndodh më së shumti midis bashkëmoshatarëve në shkollë.

Gjithashtu, në mjediset e tjera shoqërore, ku ata kalojnë kohë për të pushuar dhe argëtuar janë vendet ku ndonjëherë nuk respektohen këto të drejta në mënyrën e duhur.


Çfarë po ndodh në shkollën tonë?!

Figura 1: A ka ndodhur në prezencën tuaj që një bashkëmoshatar/person është paragjykuar nga Shoku/Shoqja e klasës, Mësuesi/Mësuesja, Familjarët, etj. ?



► Shkaqet që nxisin bullizmin, diskriminimin, paragjykimin ndaj fëmijëve

Figura 2: Shkaqet që nxisin bullizmin, diskriminimin, paragjykimin sipas nxënësve



Fëmijët kalojnë shumë kohë në ambientet e shkollës dhe familjes, për këtë arsye gjatë takimeve shkolla u përmend si hapësirë fizike ku ndodhin më shpesh ngjarje diskriminuese dhe bullizuese. Më pas u nënvizuan grupimet shoqërore jashtë ambienteve të shkollës dhe dukuria e viteve të fundit, diskriminimi dhe bullizmi në platformat online. Nxënësit përmendën disa nga shkaqet kryesore që nxisin bullizimin, siç janë midis tyre *paraqitja e jashtme fizike dhe veshja* (83%), *dallimi racor, gjinor, etnik dhe përkatësia fetare* (77%). Më së shumti ata deklaruan se ndryshimet mes njëri-tjetrit në aspekte të ndryshme si nga pamja fizike (si psh pesha, gjatësia), *gjendja ekonomike* (71%), mënyra dhe stili i veshjes, janë shkaqe që krijojnë mosbarazi dhe ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e nxënësve midis tyre, krijojnë konflikte e në disa raste çojnë deri në bullizëm. Këta konflikte fillojnë në klasë në përgjithësi, gjatë kohës së pushimit, por ndonjëherë edhe gjatë orëve të mësimit. Shumica e nxënësve e perceptojnë vënien në dukje të dallimeve fizike midis tyre si një mënyrë për të bërë shaka dhe për t'u argëtuar mes njëri tjetrit, pa dashur të ofendojnë, prandaj nuk i konsiderojnë si raste bullizmi. Nga ana tjetër, disa nxënës, pohuan se (mos)pranimi i shakasë varion nga një nxënës në tjetrin. Disa treguan shembuj konkretë, ku ata janë ndjerë të bullizuar për shkak të gjatësisë, peshës trupore, modelit të flokëve etj. **Diskriminimi gjinor** u nënvizua nga vajzat të cilat u shprehën se në shumë raste bullizohen nga djemtë duke mos i lënë të flasin në debatet që krijohen në klasë.

Një nxënës u shpreh se prindërit nuk e lejonin të luante me fëmijët romë, por pas këmbënguljes së saj, ky insistim nuk ndodh më. Edhe pse gjatë takimeve u sollën disa raste suksesi, nga sondazhi anomin rezultoi se 43% e nxënësve pjesëmarrës, janë të mendimit se aftësia ndryshe është një nga shkaqet që nxit paragjykimin, bullizmin e diskriminimin. Gjithashtu ata shtuan se nxënësit më të ndrojtur, të urtë ose me probleme të ndryshme personale dhe familjare janë nga më të prekurit nga bullizmi.

Familjarët ushtrojnë presion tek ata duke i thënë që mos të shoqërohen me nxënës me rezultate jo të mira në mësim (43%). Nxënësit deklaruan gjithashtu se *bullizimi shpesh herë lind në rrjete sociale* dhe më pas debatet zhvillohen në ambientet e shkollës dhe jashtë saj. Fatmirërisht ata

u shprehën se pjesa më e madhe e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve janë keqkuptime që zgjidhen shumë shpejt midis tyre pa u zgjatur shumë në kohë.


Sipas tyre, bullizmi i nxënësve më të rritur ndaj atyre më pak të rritur ndodh rëndom, nxënësit e klasave më të ulta (43%), bullizohen nga nxënës të klasave më të larta. Gjithashtu, ata u shprehën se nxënësit me rezultate të shkëlqyera (26%), që mësojnë shumë apo lexojnë edhe libra jashtë shkollorë, i vendosen epitete **të ndryshme** nga bashkëmoshatarët e tyre. Kjo shkakton trysni dhe presion tek këta nxënës, herë-herë edhe izolim shoqëror.

Media është një faktor tjetër ndikues për nxënësit që nxisin diskriminimin dhe bullizmin. Përmbajtja e emisioneve të ndryshme ku promovohet herë pas here bullizmi, nuk krijon shembuj pozitivë madje ndodh e kundërta.

Nxënësit u shprehën se vetëm ndonjëherë opinioni i tyre nuk respektohet nga mësuesit.

▶ **Reagimi i nxënësve ndaj rasteve konkrete të bullizmit, diskriminimit dhe paragjykit**

Figura 3: **Si keni reaguar ndaj rasteve konkrete të bullizmit?**



Reagimet konkrete të nxënësve ndaj rasteve të hasura të bullizimit ishin të shumta, duke filluar nga përpjekjet e tyre me ndërhyrje direkte për të mbrojtur dhe për të mbështetur të bullizuarit gjatë një konflikti (85%), deri në përfshirjen e mësuesve dhe të prindërve. Ata përmendën se në disa raste (64%) **kanë lajmëruar menjëherë mësuesit kujdestar, psikologun (27%)** apo punonjës in social. Disa preferojnë t'i diskutojnë shqetësimet që ata ndejnë dhe problematikat e hasura në shtëpi më **prindërit e tyre (30%)**, ku u veçua nëna si personi i parë që ata kontaktojnë në rastet kur ata vetë ose shokët e tyre përballen me raste bullizimi. Gjithashtu, nxënësit shprehën se ekzistojnë edhe raste kur nuk i tregohet prindërve për situatat që ndodhin në shkollë apo jashtë saj për të evituar debatin me ta. Të paktë ishin ata që u shprehën se kur ballafaqohen me të tilla situata nuk reagojnë fare (6%).

Gjithsesi, ata pohuan se ndihen të paragjykuar nga nxënësit e tjerë nëse lajmërojnë direkt mësuesit si dhe kanë akoma ndrojtje për të kontaktuar psikologun. Si rrjedhojë një nxënës u shpreh se u ballafaqua me shokun e tij kur dëgjoji të ofendonte familjarët e tij. Ai u shpreh se e kishte goditur me shuplakë edhe pse e pranonte se nuk ishte zgjidhja më e mirë.

Në raste shumë të rralla, nxënësit kur ndihen të diskriminuar apo të bullizuar, iu drejtohen direkt psikologut pa u referuar nga mësuesi kujdestar. Duhet theksuar se ky fenomen po ndodh më shpesh dhe **rol i psikologut** po merr rëndësinë e duhur duke vendosur një të tillë në çdo shkollë. **Oficeri i sigurisë** është gjithashtu një pozicion relativisht i ri në shkolla dhe nxënësit iu drejtohen atyre rrallë.

4.2.2 Staf i arsimor dhe mbështetës

► **Respektimi i të drejtave të fëmijëve nga këndvështrimi i mësuesve dhe stafit mbështetës.**

Stafi arsimor dhe mbështetës (këtu mësues, psikolog, punonjës social dhe oficer sigurie) luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e marrëdhënieve me nxënësit pasi ata janë të parët që përballen me situatat problematike që mund t'u ndodhin nxënësve.

Gjatë takimeve, ata u treguan shumë të gatshëm për të bashkëbiseduar, për të ndarë mendimet dhe eksperiencat e tyre mbi të drejtat e fëmijëve, respektimin dhe zbatimin e tyre.

Gjatë takimit, mësuesit treguan mbi programet mësimore dhe kurrikulat e përgatitura lidhur me hapësirën që i kushtohet ndërgjegjësimit mbi respektimin e të drejtave të njeriut gjatë lëndëve të qytetarisë, edukimit shoqëror etj. Gjithashtu, ata deklaruan se bëhet përpjekje e vazhdueshme për të inkurajuar respektimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë, familje dhe ambiente të tjera shoqërore. Mësuesit i japin mundësi nxënësve të shprehin lirshëm pikëpamjet e tyre gjatë kurrikulave të ndryshme që ata zhvillojnë.

Ata theksuan se nxënësit janë të vetëdijshëm që mund të shkojnë menjëherë tek psikologu ose punonjësi social në rast se kanë nevojë për konsultime individuale apo në grup. Më tej, ata vunë në dukje, të mbështetur edhe nga prindërit të cilët ishin prezentë gjatë takimeve, se nxënësit duhet të mbajnë më shumë përgjegjësi për veprimet e tyre dhe të bëhen më të përgjegjshëm ndaj zbatimit të detyrave që ata kanë, përveç pritshmërisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave nga mësuesit e tyre.

Gjatë gjithë vitit akademik zhvillohen orë këshillimore mbi tema të ndryshme ku janë të përfshira, në një pjesë të mirë, edhe të drejtat e fëmijëve, respektimi apo pasojat nga shkelja e tyre.

Gjithashtu, stafi arsimor dhe mbështetës marrin pjesë vazhdimisht në trajnime të ndryshme mbi tema sociale ku zhvillojnë njohuritë dhe shkëmbejnë eksperiencat. Një theks i veçantë u vendos tek bashkëpunimi, këshillimi dhe ndihmesa midis kolegëve si mënyrë e duhur dhe e rëndësishme për trajtimin e problematikave të ndryshme.

▶ ***Shkaqet që nxisin bullizmin, diskriminimin, paragjykimin ndaj fëmijëve në ambientet e shkollës***

Në përgjithësi, stafi arsimor dhe mbështetës janë të mendimit se shkaku

kryesor që nxit bullizimin midis fëmijëve në ambientet e shkollës është **paraqitja fizike (47%)**, si për shembull peshë, gjatësia, vendosja e syzeve etj. Gjithashtu, **nxënësit me aftësi ndryshe (27%)**, me **nivel ekonomik të ulët (27%)** si dhe ata të cilët i përkasin **komuniteteve të ndryshme** si rom, egjiptian etj (20%) bien pre e bullizmit nga bashkëmoshatarët e tyre. Sipas mësuesve, nuk janë të pakta rastet ku nxënësit me rezultate jo të mira (13%) si dhe ata me rezultate të shkëlqyera në mësimet (7%) bullizohen pikërisht për këto arsye. Gjithashtu, ata cituan se nxënësit e klasave më të ulta bullizohen nga nxënësit e klasave më të larta (7%).

Gjatë takimeve ballë për ballë, mësuesit dhe stafi mbështetës vunë në dukje se një nga arsyet kryesore është edhe niveli i ndryshëm arsimor dhe kulturor i nxënësve. Nxënësit më të përgatitur mund të ofendohen, vihen në lojë dhe përçmohen sepse janë aktiv dhe të përfshirë gjatë orëve të mësimetve. Madje në një rast konkret, një nxënës kishte deklaruar tek mësuesja se ishte ndjerë i/e bullizuar për shkak se lexonte shumë libra, ishte i/e artikuluar në biseda dhe për këtë ishte tallur dhe ofenduar shpesh nga disa nxënës të klasës, duke e bërë të ndihet keq.


Mësuesit cituan gjithashtu edhe **Bullizmin Online**, një fenomen në rritje, i cili ndodh në rrjetet sociale dhe si pasojë konflikti transferohet në ambientet e shkollës. Stafi arsimor dhe mbështetës shpesh ballafaqohen me të tilla situata dhe nuk janë të informuar mbi shkaktarin e konfliktit. Në këto raste ndodh që edhe prindërit kërkojnë mbështetje në shkollë për të gjetur zgjidhje kur fëmija ka pësuar bullizëm online.

Ata shtuan se konflikte dhe ofendime të ndërsjellta krijohen edhe kur nxënësit kanë opinione të ndryshme mbi një situatë të caktuar.

Më tej, një mësuese u shpreh se **nxënësit ndonjëherë nuk e kuptojnë konceptin e bullizmit dhe çdo ndjenjë negative e etiketojnë si bullizëm.**

Gjithashtu, vlen të përmendet fakti se mësuesit vendosën theksin edhe **tek bullizmi që pësojnë mësuesit nga nxënësit** duke mos u trajtuar si raste problematike, fenomen që duhet t'i jepet rëndësia e duhur, sipas tyre.

Figura 4: *Shkaqet që nxisin bullizmin, diskriminimin, paragjykimin sipas stafit arsimor dhe mbështetës*



► *Masat e marra, mekanizmat e përdorura për të parandaluar këto raste*

Mekanizma të caktuar për parandalimin dhe ndalimin e rasteve diskriminuese dhe bullizuese përdoren gjerësisht nga **stafi arsimor dhe mbështetës** edhe pse disa herë nuk japin rezultatin e dëshiruar. Në shkollë i jepet më shumë prioritet **mekanizmave edukues** siç janë grupet artistike apo angazhimi i sa më shumë nxënësve në aktivitete të ndryshme sociale dhe kulturore. Gjithashtu, në shkollë zhvillohen aktivitete në të cilat përfshihen debatet për parandalimin e bullizmit, përfshirë edhe aktrime në klasë në orët e gjuhës shqipe.

Psikologu/Punonjësi Social ka një rol të rëndësishëm në parandalimin e bullizimit pasi zhvillon klasa këshillimore duke diskutuar me nxënësit dhe dëgjuar ata. Nxënësit kanë mundësinë të takojnë psikologun në çdo rast që ata duan të flasin ose të marrin këshilla. Fillimisht, nxënësit raportojnë për ndodhi të caktuara tek mësuesi kujdestar. Në rast se mësuesi kujdestar nuk arrin të gjejë zgjidhje midis nxënësve të përfshirë, i drejtohet punonjësit social ose psikologut për këshillim dhe orientim. Çdo

fillim viti, prindërit plotësojnë një formular ku japin pëlqimin dhe pranimin e tyre që fëmijët të trajtohen nga psikologu në rast nevoje. Në rastet emergjente njoftohen prindërit për të plotësuar trinomin bashkëpunues mësues-prind-nxënës. Masat ndëshkimore sipas ligjit dhe rregulloreve në zbatim aplikohen vetëm sipas rasteve specifike nga komisioni i etikës.

Oficeri i Sigurisë në shkolla është gjithashtu një mekanizëm i rëndësishëm. Funkzioni i tij kryesor parashikon plane ndërhyrje për rastet specifike. Roli i tyre është zhvillimi i klasave këshillimore për të promovuar vlerat dhe shmangien e dhunës. Funkzioni i oficerit të sigurisë është garantimi i një mjedisi të nxëni të sigurt për fëmijët dhe për komunitetin e shkollës.

Oficerët e sigurisë në shkollë janë persona të përgatitur dhe të trajnuar:

- » për të parandaluar dhe për të menaxhuar rastet e krimit dhe të dhunës në shkollë;
- » për të bashkëpunuar me drejtorinë e shkollës, mësuesit, psikologun dhe anëtarë të tjerë të stafit për parandalimin dhe ndërhyrjen në rastet e:
 - thyerjes së disiplinës, dhunës brenda shkollës, ngacmimeve jashtë perimetrit të shkollës, përdorimit të mjeteve të forta, përdorimit të armëve të ftohta apo atyre të zjarrit, përdorimit të lëndëve narkotike, duhanit, alkoolit, menaxhimit të krizave, emergjencave etj.;
- » për të mbështetur të rinjtë dhe prindërit në zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe në menaxhimin e konflikteve;
- » për të zhvilluar biseda (me të rinjtë, prindërit, mësuesit etj....)

▶ **Trajtimi i rasteve konkrete nga stafi arsimor dhe mbështetës**

Mësuesit u shprehën se i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë situatat e krijuara nga paragjykimet dhe i krijojnë mundësi t'i zgjidhin ato midis njëri-tjetrit. Shpesh herë, konfliktet e ndodhura nga bullizmi fillojnë si shaka midis nxënësve dhe përshkallëzohen duke mos njohur kufi.

Një vajzë nga komuniteti rom diskriminohej nga bashkëmoshatarët e saj, por duke folur në klasë rreth situatës dhe efektet e sjelljes së tyre u arrit të zgjidhej dhe të kërkohet falje.

Mësuesit dhe stafi mbështetës i japin vetëbesim nxënësve që ndihen të paragjykuar për shkak të aftësive ndryshe apo nivelit arsimor dhe ekonomik. Ata punojnë me nxënësit duke i nxitur të bashkëpunojnë mes tyre dhe të jenë më të hapur, duke i shprehur shqetësimet gjatë orëve të konsultave, gjatë takimeve periodike me punonjësit socialë etj.

Si shembull: Një nxënës i cili kishte vënë syze i ishte shprehur prindërve se hezitonte të shkonte në shkollë se ndoshta bullizohej nga nxënësit e tjerë. Pas referimit të situatës tek mësuesi kujdestar, u zhvillua diskutim mbi paraqitjen e jashtme, duke i trajtuar syzet si aksesore të domosdoshëm për persona të caktuar.

Në veçanti, mësuesit deklaruan gjithashtu se janë të vëmendshëm gjatë orëve të vizatimit pasi ndodh që fëmijët të shprehin nëpërmjet pikturave shqetësimet që ndjejnë. Më tej mësuesit janë të kujdesshëm kur ndonjë nxënës izolohet nga të tjerët dhe nuk ka dëshirë të socializohet, i cili mund të jetë rast referimi për etapa të mëtejshme.

4.2.3 Prindërit

► **Perceptimi i prindërve mbi të drejtat e fëmijëve dhe rastet diskriminuese**


Pjesëmarrja e prindërve në takimet e organizuara u vlerësua shumë, pasi këta të fundit përfshihen rrallë në mënyrë të drejtpërsëdrejtë në aktivitete ku trajtohen tema të tilla. Në përgjithësi prindërit të cilët morën pjesë, ishin aktivë dhe bashkëpunues për të ndarë opinionet dhe përvojën e tyre.

Prindërit u shprehën se të drejtat e fëmijëve respektohen më së shumti në familje, por janë të kënaqur edhe me respektimin e tyre në shkollë. Ata shtuan se fëmijët këmbëngulin për të drejtat e tyre, por harrojnë se kanë edhe përgjegjësi. Fëmijët shprehen në çdo debat ose diskutim se kanë të drejtën e fjalës, por ndodh që i tejkalojnë kufijtë.

Përtej sa më sipër, ata treguan se raste diskriminimi, paragjykimi dhe bullizmi midis nxënësve, që çojnë në mosmarrëveshje në ambientet e shkollës nuk mungojnë. Në shumicën e rasteve këto konflikte janë zgjidhur nga vetë fëmijët me mbështetjen e stafit arsimor dhe mbështetes, por ndërhyrja e prindërve ndodh jo pak herë, sidomos tek nxënësit në moshë më të vogël. Shpesh, prindërit e nxënësve të përfshirë në situata konfliktuale takohen dhe bisedojnë për të pajtuar fëmijët e tyre. Gjithashtu në disa raste, prindërit **këshillojnë dhe udhëzojnë fëmijët e tyre** të komunikojnë dhe të ballafaqohen me shokun/shoqen për të zgjidhur konfliktet dhe mosmarrëveshjet mes tyre.

Prindërit janë të mendimit se **orët edukative** që zhvillohen në shkolla ku trajtohen tema të cilat kanë në fokus nxënësit dhe krijohen diskutime janë me vlera për parandalimin e fenomeneve negative. Në përgjithësi, prindërit deklaruan se fëmijët tregojnë mbi ndodhitë në shkollë, por ka dhe raste që i fshehin sidomos nxënësit në moshën e adoleshencës.

Figura 5: *Vendet ku ndodhin ngjarjet diskriminuese sipas Prindërve*



Siç mund të vihet re nga grafiku i mësipërm, 50% e prindërve pjesëmarrës në takime, shprehen se **ngjarjet diskriminuese ndodhin në grupime shoqërore jashtë ambienteve të shkollës**, 44% e tyre mendojnë që fëmijët e tyre me **ngjarje diskriminuese në shkollë**. Një pjesë e mirë (25%) deklaroi se tashmë **diskriminimi online** përhapet nëpërmjet rrjeteve sociale, por nuk mungojnë as rastet kur vetë ambientet familjare (13%) janë burime të rasteve diskriminuese.

► **Sfidat e hasura nga prindërit në lidhje me edukimin e fëmijëve**

Prindërit shprehën se sfida kryesore e hasur në edukimin e fëmijëve është diferenca midis brezave dhe **mungesa e komunikimit** ndërmjet tyre dhe fëmijëve. Ata shpjeguan se ndodh herë herë që ngjarjet që iu ndodhin fëmijëve të tyre nuk i marrin seriozisht dhe kur përshkallëzohet situata, gjenden të papërgatitur.

Gjithashtu, ata u ankuan se jo rrallë herë kanë debate për shkak të **kërkesave të shumta** të fëmijëve dhe mundësisë së ulët **ekonomike** për t'i plotësuar. Nxënësit vënë re veshjet, pajisjet teknologjike të njëri-tjetrit dhe kërkojnë nga prindërit që të kenë po të njëjtat apo të ngjashme me ata që kanë bashkëmoshatarët e tyre. Për këtë ata këmbëngulin se është e drejtë e tyre. Kjo është më shumë e dukshme tek nxënësit në moshë më të rritur.

Nga ana tjetër, një prind deklaroi se kishte hasur **vështirësi me fëmijën kur kishin kaluar nga fshati në qytet**. Kjo shpërngulje solli vështirësi në integrimin e fëmijës në shkollë nga frika e paragjykimeve, por me bashkëpunimin e mësuesve dhe kalimin e kohës dhe ky problem u tejkalua. Prindërit përballen me situata të ndryshme me fëmijët e tyre, të cilat mundohen t'i japin **zgjidhje nëpërmjet komunikimit me mësuesit ose me prindërit e tjerë**.

▶ **Reagimi i prindërve ndaj rasteve konkrete lidhur me diskriminimin, bullizmin dhe paragjykimin në shkolla**

Gjatë takimeve të kryera, prindërit deklaruan se në shumicën e rasteve fëmijët bisedojnë paraprakisht me nënat e tyre për problemet e hasura e më pas, nënat diskutojnë me prindin tjetër të fëmijëve. Reagimet e prindërve në raste konkrete bullizimi janë bisedat dhe ndërjegjësimi i fëmijëve të tyre kur janë ata shkaktarët dhe jo vetëm. Njëkohësisht ata kontaktojnë dhe bisedojnë mbi situatat e krijuara edhe me mësuesit kujdestarë. Në përgjithësi ata deklaruan se takohen edhe me prindërit e fëmijës tjetër, diskutojnë me to dhe mundohen të zgjidhin problemet e ngritura. Këto takime ndodhin më së shumti në bashkëpunim edhe me mësuesit. Në rast konflikti midis fëmijëve, ka ndodhur që prindërit janë konfliktuar me njëri-tjetrin pa pasur informacionin e duhur se çfarë ka ndodhur në realitet. Madje ka pasur raste që fëmijët janë pajtuar dhe prindërit kanë vazhduar konfliktin me njëri – tjetrin duke dhënë shembull jo të mirë. Një prind pjesëmarrës, shpjegoi se në një situatë konfliktuale midis dy nxënësve, fëmija e saj ishte shkaktari, për këtë arsye ajo e nxiti të kërkonte falje dhe të zgjidhej problemi. Prindërit angazhohen të flasin për të tilla tema me fëmijët dhe të kuptojnë më shumë nga bota e tyre për të tejkaluar situatat.

▶ **Bashkëpunimi Prindër – Staf Arsimor dhe Mbështetës**

Bashkëpunimi midis prindërve dhe stafit arsimor dhe mbështetës është një faktor kyç dhe shumë i rëndësishëm për të përmirësuar atmosferën shkollore dhe për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë respektin, tolerancën dhe sjelljen pozitive ndaj njëri-tjetrit. Angazhimi i përbashkët për të krijuar një mjedis të sigurt dhe edukues në shkollë, ku vlerat themelore shoqërore janë në qendër të vëmendjes është thelbi i këtij bashkëpunimi. Për punuar së bashku, prindërit dhe stafi arsimor dhe mbështetës mund të kontribuojnë në zvogëlimin e niveleve të diskriminimit dhe bullizmit në ambientin shkollor.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi midis tyre përfshin komunikimin e vazhdueshëm dhe të hapur për të adresuar sfidat që mund të lindin. Ky dialog është thelbësor për zvogëlimin e nivelit të diskriminimit dhe bullizmit në shkolla. Prindërit mund të jenë partnerë aktivë në hartimin e politikave dhe praktikave që promovojnë respektin dhe tolerancën, ndihmuan në ndërtimin e një kulture të respektit ndaj ndryshimeve dhe ndihmuan në kultivimin e sjelljes pozitive ndaj të tjerëve.

Prindërit u shprehen se ata bashkëpunojnë me mësuesit dhe stafin mbështetës kryesisht gjatë **takimeve me prindër** ku diskutojnë dhe marrin informacionin mbi rezultatet e nxënësve, si dhe një vlerësim mbi të ecurisë së përgjithshme. Ky informacion përfshinë vlerësimet, provimet, projektet dhe sjelljen në klasë. Mësuesit njoftojnë prindërit mbi situatat konfliktuale për të gjetur zgjidhje nga të gjithë palët e përfshira. Gjithashtu, disa mësues përdorin metoda shtesë për komunikim më të shpejtë dhe me efikase me prindërit si: **grupe whatsapp-i** të përbashkëta, etj.

5. Sugjerime për përmirësim

5.1 Sugjerimet e nxënësve si të eliminohet diskriminimi dhe bullizmi.

• Për Stafin Arsimor dhe Mbështetës

Nxënësit preferojnë që t'i diskutojnë dhe mundohen fillimisht t'i zgjidhin midis tyre konfliktet e krijuara. Ata gjithashtu u shprehën se **stafi arsimor dhe mbështetës duhen të komunikojnë më shumë me nxënësit** dhe t'i udhëzojnë ato për efektet negative të bullizmit. Ndihma e psikologëve dhe punonjësve socialë në shkolla dhe ndërhyrja e menjëhershme e tyre janë mënyrat më të mira për të parandaluar rastet e bullizimit dhe diskriminimit.

Gjithashtu vetë nxënësit shprehën dëshirën ndaj fëmijëve që ushtrojnë presion ose sjellje të dëmshme ndaj fëmijëve të tjerëve në mënyrë të njëanshme ose ofenduese, pra sic i quajnë ata “bullizuesit”, duhet të marrin **masa ndëshkuese** ose **orë këshillimore** për të mos përsëritur të njëjtat ngjarje.

• Për Prindërit

Fëmijët dëshirojnë që prindërit **t'i mirëkuptojnë për zgjedhjet e tyre**, kryesisht përsa i përket shoqërisë. Ata dëshirojnë që prindërit të përpiqen të mos influencojnë në këto zgjedhje, të cilat mund të çojnë në presione psikologjike apo situata që nxisin bullizëm nga ana e fëmijëve të tjerë.

Ata gjithashtu, kërkojnë nga prindërit e tyre të tregohen **më tolerant dhe më të kuptueshëm në rastet kur fëmijët nuk arrijnë rezultate të larta** në mësimet krahasuar me pritshmëritë e tyre.

Sipas tyre, është shumë e rëndësishme që prindërit të jenë të gatshëm dhe të hapur të dëgjojnë dhe të marrin seriozisht shqetësimet e fëmijëve të tyre. Kjo përfshin dëgjimin e historive të tyre rreth diskriminimit dhe bullizmit pa gjykuar apo minimizuar situatat në të cilat mund të gjenden. Ambienti familjar dhe shembulli pozitiv nga ana e prindërve do t'i

ndihmonte të mësojnë se sa e rëndësishme është të respektojnë dhe të vlerësojnë ndryshimet dhe diversitetin midis njëri tjetrit.

• **Për Bashkëmoshatarët**

Nxënësit dëshirojnë të ndjehen të mirëkuptuar dhe të respektojnë njëri-tjetrin, duke shmangur krahasimet të panevojshme dhe duke vlerësuar ndryshimet e tyre. Ata theksojnë **rëndësinë e empatisë**, pra të vendosin veten në vend të tjetrit, si një mjet për të kuptuar perspektivat e të tjerëve, para se të kritikojnë ose ofendojnë. Në rast të ndeshjes me bullizmin, ata përqendrohen në komunikimin me mësuesit ose prindërit, në vend të përgjigjes me bullizëm.

Nxënësit dëshirojnë të krijojnë një mjedis shkollor ku të ndjehen të mirëkuptuar dhe të respektuar nga njëri-tjetri. Në vend që të evidentojnë dallimet dhe dobësitë e njëri-tjetrit, ata shprehin se duhet të preferojnë **të kthejnë vëmendjen tek vlerat dhe pozitiviteti** që secili individ sjell në grup.

Një koncept thelbësor që nxënësit theksojnë është **rëndësia e empatisë**. Ata besojnë në mënyrën sesi empatia mund të ndihmojë në ndërtimin e marrëdhënieve të mira në shkollë. Për ta praktikuar empatinë, ata paraqesin ide se duhet të vendosin veten në vendin e të tjerëve. Ky veprim i lejon atyre të kuptojnë më mirë pikëpamjet dhe ndjenjat e të tjerëve. Në vend të kritikave dhe ofendimeve për çdo sjellje negative apo mangësive në paraqitje apo veshje, ata shtojnë se duhet të kërkojnë të kuptojnë arsyet pse një person ka vepruar apo paraqitet në një mënyrë të caktuar dhe të ofrojnë përkrahje dhe mirëkuptim.

Një tjetër element i rëndësishëm që nxënësit theksojnë është **reagimi ndaj bullizmit**. Ata e kuptojnë që duhet të jenë tolerant dhe pranojnë diversitetin gjë që është e domosdoshme për të siguruar një mjedis shkollor të sigurt dhe të këndshëm. Përgjigja e tyre ndaj rasteve të ndryshme të bullizmit është e qartë: **Nxënësit nuk duhet të përgjigjen me bullizëm ndaj tjetrit**. Në vend të kësaj, ata duhet të informojnë mësuesit ose prindërit në lidhje me çdo rast të bullizmit që hasin. Ata shprehin se

besojnë në fuqinë e komunikimit të hapur dhe të bashkëpunimit për të adresuar këto çështje.

Në thelb, nxënësit dëshirojnë të ndjehen të përfshirë dhe të aftësohen për të ndihmuar në ndërtimin e një mjedisi shkollor pranues dhe mbështetës. Ata e shohin respektin dhe empatinë si mjetet kryesore për të arritur këtë qëllim dhe janë të gatshëm të luftojnë kundër bullizmit duke iu drejtuar figurave autoritare brenda shkollës së tyre. Qëndrim pozitiv dhe ndërgjegjësimit i nxënësve janë elemente kyçe për ndryshimet pozitive në kulturën shkollore, sipas tyre.

Edukata, mirëkuptimi, toleranca duhet të mbizotërojnë në komunikimin midis tyre.

5.2 Sugjerimet e stafit arsimor dhe mbështetës si të eliminohet diskriminimi dhe bullizmi

Mësuesit u shprehën se bullizmi mund të parandalohet nëse nxënësit mësojnë të respektojnë ndryshimet dhe dallimet që ekzistojnë midis njëritjetrit. **Gjithëpërfshirja** e nxënësve në aktivitete të ndryshme do të ishte me shumë vlerë si dhe **bashkëpunimi midis mësuesve-prindërve-punonjësit social/psikologut**.

Ndërgjegjësimi i nxënësve në mënyrë të vazhdueshme mbi tema të tilla si Të Drejtat e Fëmijëve dhe promovimi i tolerancës dhe mirëkuptimit është thelbësore në trajtimin e diskriminimit dhe bullizmit. Nxitja e vetëvlerësimit tek nxënësit ishte një aspekt tjetër për t'u marrë në konsideratë në parandalimin e situatave bullizuese.

Gjithashtu, **stafi mësimor dhe mbështetës duhet të trajnohet vazhdimisht** për të menaxhuar në mënyrë efektive rastet që paraqiten. Teknologjia sjell situata nga më të ndryshmet që mund t'i gjejë të papërgatitur dhe pa njohuritë specifike stafin në shkolla.

Krijimi i një **mjedisi bashkëpunues** nga të gjithë anëtarët e stafit mësimor dhe mbështetës ku nxënësit të ndihen të lirë për të raportuar rastet e diskriminimit dhe bullizmit, mbart një rëndësi të veçantë.

5.3 Sugjerimet e prindërve si të eliminohet diskriminimi dhe bullizmi

Prindërit kanë propozuar një sërë masash dhe veprimeve për të adresuar çështjet e bullizmit dhe diskriminimit midis fëmijëve në ambientin shkollor.

Këto sugjerime vijojnë si mëposhtë :

- Angazhimi dhe inkurajimi për një **Komunikim Efektiv me fëmijët** është thelbësor për të ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe të ndërgjegjësimit të tyre në mënyrë që të kuptojnë dhe parandalojnë bullizmin dhe diskriminimin në mjedisin shkollor. Prindërit e shohin komunikimin si një mjet kryesor për të ndihmuar

fëmijët të kuptojnë fenomenet e bullizmit dhe diskriminimit dhe për t'i inkurajuar ata të raportojnë rastet e tyre.

- **Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere** për fëmijët mbi këto tema, të cilët sipas tyre mund t'i ndihmojnë ata të informohen më tepër mbi rrezikun e këtyre sjelljeve negative.

- **Angazhimi i vetë prindërve në aktivitete ndërgjegjësuere, informuese dhe edukuese** që i aftësojnë për të komunikuar më mirë me fëmijët e tyre dhe për të kuptuar më thellë fenomenet e bullizmit dhe diskriminimit.

- **Bashkëpunim i vazhdueshëm mes prindërve dhe stafit arsimor** dhe atij mbështetës, i domosdoshëm për të parandaluar këto fenomene.

- Krijimi i një grupi të prindërve për të vendosur **masa ndëshkimore** ishte një sugjerim i propozuar.

- **Monitorimin e rasteve të diskriminimit dhe bullizmit** për të pasur një pasqyrë të fenomeneve që ndodhin në shkollat e fëmijëve të tyre. Kjo do të ndihmojë në pasqyrën e shpërndarjes së këtyre fenomeneve dhe në zbardhjen e tyre. Përdorimi i informatave të tilla është i rëndësishëm për të ndërmarre masa efektive.

- **Përfshirja e fëmijëve në klasa sportive dhe kulturore.** Këto klasa do të ndihmonin në vetëvlerësimin e nxënësve dhe ndihmojnë ata të zbulojnë pasionet e tyre. Këto aktivitete kontribuojnë në parandalimin e sjelljeve negative midis fëmijëve dhe në përmirësimin e klimës shkollore.

6. REKOMANDIME

- **Evidentimi dhe regjistrimi i rasteve, pra krijimi i një mekanizmi të mirëpërcaktuar në çdo shkollë** (regjistër), ku mbahen evidenca mbi rastet e konstatuara, qoftë edhe kur kanë patur zgjidhje të shpejta, me qëllim që të bëhen vlerësime periodike.

- **Përfshirja e metadove interaktive dhe elementeve të lojës gjatë orëve të mësimit, ku diskutohen tema si bullizmi, diskriminimi.** Pra, të shpjegohen konceptet me situata konkrete ku dhe nxënësit të angazhohen në luajtjen e rolit “të të bullizuarit” ose “bullizuesit” për të kuptuar më mirë ndjesitë e njëri-tjetrit. Gjithashtu mund të vihet theksi tek ndarja e kufirit midis shakasë dhe shakasë së tepruar, që cënon ndjesitë e nxënësve dhe bëhet shkas për agravimin e situatave.

- **Të evidentohet roli i rëndësishëm i psikologut, punonjësit social apo oficerit të sigurisë në takimet ndërgjegjësuese** me prindërit, nxënësit dhe mësuesit, duke i përfshirë në çdo ngjarje sado të vogël, të paraqitur nga mësuesit për të mos përshkallëzuar në raste konflikti.

- **Zhvillimi i orëve edukative dhe informuese nga psikologu, punonjësi social dhe oficeri i sigurimit** mbi Edukimin për Qytetari Demokratike, Të Drejtat e Fëmijëve nëpërmjet temave të ndryshme sociale si: respektimi i hapësirës individuale, komunikimi, vetëvlerësimi dhe vetëbesimi, mentaliteti, izolimi social etj.

- **Organizimi i takimeve ndërgjegjësuese me prindërit dhe kujdestarët e nxënësve** në mënyrë periodike mbi bullizmin, diskriminimin dhe tema të tjera për të patur koncepte të qarta mbi këto fenomene nga të gjitha palët.

- Të prezantohen **shembuj pozitivë suksesi**, duke ftuar individë të profesioneve të ndryshme që janë hasur me bullizmin në moshën e nxënësve në orë këshillimore ose aktivitete të ndryshme.

- Të zhvillohen orë **edukimi mediatik**, duke vënë theksin tek mediat sociale dhe platformat e ndryshme në internet që përdoren nga nxënësit si shkaktarë nxitës të situatave të ndryshme konfliktuale.

- T’i jepet rëndësi e veçantë **konkurseve, artistike apo aktiviteteve** të ndryshme, për të krijuar sinergji pozitive midis nxënësve dhe punës në grup.

7. Foto Galeri

Lunch Talks në shkollën “Jeronim De Rada”



Lunch Talks në shkollën “Imelda Lambertini”



Lunch Talks në shkollën “Shushicë”



Lunch Talks në shkollën “Fuat Babani”



8. ANEKS 1 (Pyetësor për nxënësit)



Pyetësor: Opinioni juaj vlen!

1. Shkolla:

Shkolla 9 vjeçare "Imelda Lambertini", Elbasan Shkolla 9-vjeçare " Jeronim De Rada", Elbasan

Shkolla 9-vjeçare "Shushice", Elbasan

2. Moshë :

10-12 vjeç 13-15 vjeç 16-19vjeç Mbi 18 vjeç

3. Gjinia :

Femer Mashkull

4. Cilat nga te Drejtat e Femijeve , te listuara me poshte njihni?

- E drejta per te patur nje identitet E drejta per te patur nje familje
 E drejte per te permbushur nevojat themelore per mbrojte fizike,ushqim etj
 E drejta per te patur kujdes shendetesor E drejta per te qene te barabarte
 E drejta per arsim universal te paguar nga shteti E drejta per te patur mbrojte te barabarte te te drejtave civile te femijes E drejta per te shprehur mendimin e lire E drejta per te pushuar dhe argetuar E drejte per te praktikuar lojera dhe veprimtari lodhese, ne perfatje me moshen, si dhe per te marre pjese ne aktivitete kulturore dhe artistike
 Liria dhe diskriminimi ne baze te races se femijes , gjinise , orientimit seksual,identitetit gjinor, origjines kombetare, fese, paafesise, ngjyres, perkatesise etnike ose karakteristikave te tjera Te tjera

5. A mendoni se te drejtat e femijeve respektohen:

	Gjithmone	Me se shumti respektohen	Me se shumti nuk respektohen	Asnjehere
Ne Shkolle	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ne familje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ne ambiente te tjera shoqerore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

6. Ne opinionin tuaj, cilat ng ate drejta e femijeve NUK respektohen?

	Ne shkolle	Ne familje	Ne shoqeri jashte shkolle
E drejta e identitetit per te patur nje identitet	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E drejta per te patur nje familje, per te patur kontakt me te dy prinderit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E drejta per te permbushur nevojat themelore per mbrojte fizike,ushqim etj	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E drejta per te patur kujdes shendetesor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E drejta per te qene te barabarte	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E drejta per arsim universal te paguar nga shteti	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E drejta per te patur mbrojte te barabarte te te drejtave civile te femijes	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E drejta per te shprehur mendimin e lire	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E drejta per te pushuar dhe argetuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E drejta per te praktikuar lojera dhe veprimtari lodhese , ne perfatje me moshen, si dhe per te marre pjese ne aktivitete kulturore dhe artistike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Liria nga diskriminimi ne baze te races se femijes,gjinise, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjines kombetare, fese,paafesise,ngjyres,perkatesise etnike ose karakteristikave te tjera	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Ky pyetesor zhvillohet ne kuader te projektit "Forcimi i Edukimit per Qytetari Demokratike ne Shqiperi" zbatohet nga Keshilli i Evropes dhe financohet nga Agjencia Suedeze per Bashkepunim dhe Zhvillim Nderkombetar (Sida) People in Focus eshte organizate partnere ne zbatimin e projektit, ne shkollat fillore "Imelda Lambertini", "Jeronim de Rada", "Shushice" ne Elbasan dhe ne shkollet e mesme "Fuat Babani" ne Devoll, Korçe.



7. Ku ndodhin me shpesh ngjarjet diskriminuese/bullizuese?

- Në shkollë Në shtëpi Online Ambiente familjare Në grupime shoqërore jashtë shkollë
 Të tjera _____

8. Cilat janë shkaqet që nxënësit diskriminimin/bullizimin/paragjykimin?

- Paragjykit fizike Nxënësit që janë me të dobët në rezultatet shkollërore Raca
 Niveli ekonomik Nxënësit me aftësi ndryshe
 Nxënësit që janë me të suksesshem në rezultatet shkollërore
 Nxënësit që ndodhen në klasa/vite me të uleta

9. A ka ndodhur në prezencën tuaj që një bashkëmohatar/individ është diskriminuar nga :

	Po	Jo
Shoku/Shoqja e klases	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mesuesi/Mesuesja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit/Familjare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shoqëria jashtë ambientit shkollor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

10. Nese PO, si keni reaguar ju?

- Kam ndërhyrë për të mbrojtur Kam lajmëruar mesuesin kujdestar Kam lajmëruar psikologun/psikologen e shkollës
 Ishte dhe një si police po më kujtohet si qubë Kam biseduar me prindërit e mi Nuk kam reaguar fare
 Tjetër _____

11. A ka ndodhur në prezencën tuaj që një bashkëmohatar/person është paragjykuar nga:

	PO	JO
Shoku/Shoqja e klases	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mesuesi/Mesuesja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit/Familjaret	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shoqëria jashtë ambientit shkollor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

12. Nese PO, si keni reaguar ju?

- Kam ndërhyrë për të mbrojtur vetën Kam lajmëruar mesuesin kujdestar Kam lajmëruar psikologun/psikologen e shkollës
 Ishte dhe një si police po më kujtohet si qubë Kam biseduar me prindërit e mi Kam biseduar me shoket/shoqet
 Nuk kam reaguar fare Other _____

13. Nese PO, ndani shkurtimisht ndodhi konkrete?

14. Po ju vete , a jeni përballur ndonjëherë me ofendime tallesh për aspekte të ndryshme apo jeni ndjere e bullizuar nga :

	PO	JO		PO	JO
Shoqja e klases	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Mesuesi/Mesuesja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit/Familjaret	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Shoqëria jashtë ambientit shkollor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

15. Po ju vete, a jeni ndjere të diskriminuar nga:

	PO	JO		PO	JO
Shoqja e klases	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Mesuesi/Mesuesja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit/Familjaret	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Shoqëria jashtë ambientit shkollor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

16. Nese PO, si keni reaguar ju?

- Kam ndërhyrë për të mbrojtur vetën Kam lajmëruar mesuesin kujdestar Kam lajmëruar psikologun/psikologen e shkollës Ishte dhe një si police po më kujtohet si qubë Kam biseduar me prindërit e mi Kam biseduar me shoket/shoqet Nuk kam reaguar fare Të tjera _____

17. Nese PO, ndani shkurtimisht ndodhi konkrete?

18. Si mund të eliminohet diskriminimi dhe bullizimi? Cilat janë sugjerimet tuaja?

Ky pyetësor zhvillohet në kuadër të projektit "Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri" zbatohet nga Këshilli i Evropës dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Nderkombëtar (Sida). People in Focus është organizatë partnere në zbatimin e projektit, në shkollat fillore "Imelda Lambertini", "Jerozim de Rada", "Shushice" në Elbasan dhe në shkollën e mesme "Fuat Babani" në Devoll, Korçë.



TIRANË 2023